



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Komuna e Klokot/Opština Klokot

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c) të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr. 28/2008), nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr. 27/2008) me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-221, Ligjit nr. 04/L-116, Ligjit nr. 04/L-194, Ligjit nr. 05/L-063, Ligjit nr. 05/L-007 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr. 76/2010, 20/2012, 28/2013, 1/2016, 13/2016), nenit 36 paragrafi 3 të Rregullorës financiare nr. 01/2013 MF-Shpenzimi i parave publike, nenit 2 të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Kuvendi Komunal i Klokot në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më : 29.03.2019 vj., aprovon këtë:

RREGULLORE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Neni 1
Zbatimi i Rregullores

1. Rregullorja për ndarjen e subvencioneve (në tekstin në mëtejme: Rregullore) rregullon kushtet, kriteret dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve të pakthyeshme financiare nga kategoria e subvencioneve për personat fizik dhe juridik (në tekstin e mëtejme: përfitues) në territorin e Komunës së Klokot.

2. Subvencionet mund t'i ndahen në fushat e mëposhtme:

1. Arsim dhe kulturë;
2. Zhvillim ekonomik;
3. Bujqësi;
4. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
5. Rini dhe sport.

Neni 2
E drejta për subvencione

Të drejtën për marrjen e subvencioneve mund ta realizojnë vetëm personat fizik me vendqëndrim/vendbanim në territorin e Komunës së Klokot dhe personat juridik (OJQ) të regjistruar me seli në territorin e Komunës së Klokot.

Neni 3

Kufizimet buxhetore

Lartësia e mjeteve financiare për kategorinë e subvencioneve përcaktohet për çdo vit fiskal veç e veç, në varësi të mjeteve që janë në dispozicion me buxhetin e Komunës së Kllokot.

Neni 4

Ndarja e subvencioneve për organizatat joqeveritare (OJQ)

1. Ndarja e subvencioneve për organizatat joqeveritare (OJQ) nga Komuna e Kllokot bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me dispozitat e Rregullores MF-nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Një organizatë joqeveritare (OJQ) mund të jetë përfituese vetëm një herë në vit të subvencioneve të ndara nga komuna, duke mos llogaritur më shunë aktivitete brenda një projekti të vetëm.

3. Nëse përfituesi i subvencioneve nuk i shfrytëzon mjetet për qëllimet e destinuara dhe në përputhje me Kontratën, ai e humb të drejtën për marrjen e subvencioneve për secilën fushë në një periudhë prej dy (2) viteve.

Neni 5

Ndarja e subvencioneve për personat fizik

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje do të zbatohen gjatë ndarjes së subvencioneve për personat fizik.

2. Personat fizik mund të jenë përfitues të subvencioneve të ndara nga komuna më së shumti dy herë në vit.

Neni 6

Paraqitja e kërkesës për ndarjen e subvencioneve

Ndarja e subvencioneve mund të bëhet vetëm në bazë të kërkesës me shkrim të paraqitur përmes shkrimoreve të komunës, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve

1. Kryetari i komunës emëron Komisionin për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për personat fizik.

2. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve mund të jenë vetëm personat e punësuar pranë Komunës së Kllokot.

3. Komisioni për vlerësimin e kërkesave përbëhet gjithsej nga tre anëtarë, nga të cilët së paku një anëtar duhet të jetë nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe 1 zyrtar nga fusha e financave.

4. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave emërohen për një periudhë prej dy (2) vjet.

5. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve kanë përgjegjësi për zbatimin e rregullt të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 8

Shqyrtimi i kërkesave dhe marrja e vendimit

1. Shqyrtimi i të gjitha kërkesave për ndarjen e subvencioneve bëhet nga Komisioni për vlerësimin e kërkesave brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

2. Komisioni për vlerësimin e kërkesave merr vendime me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

3. Komisioni do të mbajë procesverbal nga takimet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit.

4. Vendimet e Komisionit për vlerësimin e kërkesave bëhen të formës së prerë nëse ndaj tyre nuk është ushtruar ankesa brenda afatit të caktuar.

5. Komisioni i njofton parashtruesit e kërkesave për vendimet e tij, me një njoftim për procedurën e ushtrimit të ankesës.

6. Komisioni për vlerësimin e kërkesave mund të bëjë gjithashtu edhe vizitën e parashtruesve të kërkesave në terren, për të konstatuar disa fakte të nevojshme për vendim-marrje.

Neni 9

Komisioni për ankesa

1. Kryetari i komunës me vendim emëron Komisionin për ankesa me qëllim të shqyrtimit të ankesave dhe parashtrësve të paraqitura kundër vendimeve të Komisionit për vlerësim.

2. Komisioni për ankesa përbëhet gjithsej nga tre anëtarë, prej të cilëve së paku 1 anëtar duhet të jetë jurist me profesion.

3. Komisioni për ankesa do të mbajë procesverbal nga takimet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit.

4. Anëtarët e Komisionit për ankesa emërohen për një periudhë prej dy (2) vjet.

5. Anëtarët e Komisionit për ankesa nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve dhe personat e emëruar politikisht.

Neni 10
Paraqitja dhe zgjidhja e ankesës

1. Ankesa duhet të ushtrohet brenda 7 ditëve nga dita e pranimi të vendimit të Komisionit për vlerësim.
2. Komisioni e shqyrton ankesën dhe merr një vendim brenda 15 ditëve nga dita e pranimi të ankesës.
3. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Neni 11
Vendimi për ndarjen e subvencioneve

1. Vendimi për ndarjen e subvencioneve merret nga kryetari i komunës brenda 7 ditëve nga dita e vendimit përfundimtar të Komisionit për vlerësimin e kërkesave.

Neni 12
Shpallja publike për ndarjen e subvencioneve për personat fizik

1. Në rast të shpalljes së thirrjes publike për ndarjen e subvencioneve për personat fizik, shpallja publike për ndarjen e subvencioneve publikohet në ueb-faqen e komunës, tabelën e shpalljeve, mediat lokale dhe rrjetet sociale.
2. Me shpalljen publike përcaktohen me saktësi kriteret dhe procedura e paraqitjes së kërkesës, fusha në të cilën ndahen subvencionet, lartësia e mjeteve që janë në dispozicion për ndarjen e subvencioneve, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme.
3. Shpallja publike për paraqitjen e kërkesës për ndarjen e subvencioneve zgjat 15 ditë nga dita e publikimit.

Neni 13
Subvencionet për arsim dhe kulturë

1. Me subvencione në fushën e arsimit dhe kulturës nënkuptojmë:

1. Bursat për studentët;
2. Bursat për nxënësit e shkollave të mesme;
3. Bursat për nxënësit e shkollave fillore;
4. Nxënësit me nevojë të veçanta;
5. Garat apo kuizet (jashtë aktiviteteve mësimore);
6. Publikimin e librit/revistës;
7. Shoqëritë amatore (ansamblet);
8. Teatrot amatore;
9. Festivalet;
10. Ekspozitat e pikturave;
11. Promovimin e talenteve të rinj;
12. Ngjarjet kulturore.

Neni 14

Kriteret dhe dokumentacioni për ndarjen e subvencioneve

1. Kryetari i komunës me një vendim të veçantë përcakton kriteret e qarta për ndarjen e bursave, duke përfshirë:

1. Notën mesatare;
2. Numrin e studentëve/nxënësve në familje;
3. Banimin në zonat rurale;
4. Rezultatet e arritura në gara;
5. Gjendjen ekonomike.

2. Dokumentet, të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e bursave, janë:

1. Dokumenti i identifikimit;
2. Vërtetimi për notat;
3. Vërtetimi për vitin kalendarik të studimit;
4. Vërtetimi për vendbanim;
5. Vërtetimi për gjendjen ekonomike;
6. Vërtetimi për rezultatet e garave.

3. Parashtruesi i kërkesës nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse gjatë të njëjtit vit fiskal ka qenë tashmë përfitues i bursës.

Neni 15

Subvencionet për zhvillimin ekonomik

1. Subvencionet në fushën e zhvillimit ekonomik mund të ndahen për:

1. Zanatet tradicionale;
2. Pajisjet;
3. Agrobizneset;
4. Teknologjinë e informacionit;
5. Bizneset inovative;
6. Ndërmarrjet sociale;
7. Aktivitetet që promovojnë zhvillim ekonomik;
8. Aktivitetet që promovojnë zhvillimin e turizmit;
9. Bizneset “inkubator”;
10. „Start-ap” bizneset;
11. Aktivitetet që çojnë deri te rritja e punësimit.

2. Përfituesit e subvencioneve për zhvillimin ekonomik nuk mund të jenë personat juridik, të cilët kanë detyrime të pashlyera financiare ndaj komunës.

Neni 16

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillimin ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillimin ekonomik, në të njëjtat kushtet, komuna i jep përparësi rasteve të mëposhtme specifike:

1. Ndërmarrjeve që merren me prodhim, përpunim dhe shërbime, të cilat mundësojnë punësim;
2. Grave dhe sipërmarrësve të rinj, personave me nevoja të veçanta dhe grupeve të rrezikuara sociale;
3. Bizneseve që kanë siguruar financim të projektit nga pala e tretë të paktën 50% të vlerës;
4. OJQ-ve që aplikojnë me biznes-projekte, të cilët mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës.

Neni 17

Subvencionet për bujqësi

1. Subvencionet në fushën e bujqësisë mund të ndahen për:

1. Projektet e fermerëve, shoqatat, kooperativat bujqësore, fushat bujqësore që janë prioritet për komunën;
2. Organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;
3. Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
4. Projektet në fushën e pylltarisë.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve për bujqësi, nën të njëjtat kushte, komuna do t'i favorizojë:

1. Fushat prioritare të përcaktuara nga komuna;
2. Pjesëmarrjen e fermerëve në bashkë-financimin e projekteve me të paktën 50% të vlerës;
3. Gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e rrezikuara sociale.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për ndarjen e subvencioneve për bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga personat fizik gjatë paraqitjes së kërkesës për ndarjen e subvencioneve në bujqësi janë:

1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
2. Projekti dhe plani financiar;
3. Fleta poseduese e patundshmërisë;
4. Vërtetimi për pagesën e taksave komunale;
5. Vërtetimi për pagesën e tatimit mbi pronë;
6. Vërtetimi i bankës për llogarinë e hapur të parashtruesit të kërkesës.

Neni 19

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Subvencionet në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale mund të ndahen për:

1. Trajtimin e personave të sëmurë rëndë;

2. Rastet e sëmundjeve të lehta, por pa burim të të ardhurave;
3. Trajtimin jashtë vendit;
4. Maternitetin dhe stimulimin e lindjeve;
5. Fushatat e ndërgjegjësimit për shëndetin publik;
6. Gjendjen e nevojës sociale dhe mbrojtjes.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, nën të njëjtat kushte, komuna do t'i favorizojë rastet e mëposhtme specifike:

1. Familjet me numër të madh të anëtarëve,
2. Familjet me kushte të këqija të banimit,
3. Gjendja ekonomike të familjes.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga personat fizik gjatë paraqitjes së kërkesës për ndarjen e subvencioneve në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale janë:

1. Dokumenti i identifikimit;
2. Vërtetimi i bankës për llogarinë e hapur të parashtruesit të kërkesës;
3. Dokumentet me të cilat vërtetohet arsyeshmëria e kërkesës së paraqitur (raportet mjekësore, vërtetimet mbi shpenzimet e trajtimit, shuma e të ardhurave, etj.).

4. Lartësia e shumës së subvencioneve nga paragrafi 1 pika 1, 2, 3 dhe 6 të këtij neni përcaktohet nga Komisioni për vlerësimin e kërkesave, në varësi të nevojave reale të parashtruesit të kërkesës dhe mjeteve financiare në dispozicion në buxhetin e komunës.

Neni 20

Subvencionet për rini dhe sport

1. Subvencionet në fushën e rinisë dhe sportit mund të ndahen për:

1. Klubet sportive.
2. Sportistët e talentuar dhe suksesshëm;
3. Garat sportive.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, nën të njëjtat kushte, komuna do t'i favorizojë rastet e mëposhtme specifike:

1. Projektet të siguruara përmes bashkë-financimit nga pala e tretë.
2. Projektet që mund të krijojnë të ardhura financiare për parashtruesit e kërkesës për subvencionet, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e projektit në një periudhë të gjatë kohore.

Neni 21

Raportimi për shpenzimin e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve janë të detyruar që t'ia dorëzojnë komunës raportin financiar brenda 30 ditëve nga dita e shpenzimit të mjeteve të subvencioneve.

2. Raporti financiar duhet t'i përmbajë të gjitha shpenzimet e dokumentuara, të tilla si: raportet bankare, faturat e rregullta dhe të tjera me të cilat dëshmohet shpenzimi i destinuar i mjeteve.

Neni 22

Kontrolli mbi shpenzimin e subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin ndaj përfituesit mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga subvencionet, në përputhje me vendimin për ndarjen e subvencioneve.

2. Auditimi i shpenzimit të mjeteve të subvencioneve mund të kryhet në periudhën kohore deri në 3 vjet nga dita e marrjes së subvencioneve.

Neni 23

Publikimi i listës përfundimtare të përfituesve të subvencioneve

1. Lista e përfituesve të subvencioneve do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të komunës.

2. Lista e përfituesve të subvencioneve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, fushën për të cilën ndahen subvencionet dhe shumën e mjeteve të ndara.

Neni 24

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores MF-nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-nr-04/2017.

Neni 25

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje është përgjegjës kryetari i komunës.

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nr.3222/2 nga 29.03.2013.

Neni 27

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të saj në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Data: 29.03.2019 vj.

**Kryesuesi
Kuvendi Komunal Killokot**


/ Zarko Dejanović /